Për siguri dhe për pastrim maksimal, i vendosni enët prej argjendi në kosh duke u siguruar që:

- Ato nuk janë të mbivendosura.
- Enët prej argjendi janë të vendosura me dorezat poshtë.
- Por thikat dhe enët e tjera që përpëjnë rrezik vendosen me bishtat lart.



6.SI TË NISIM NJË PROGRAM LARJE

Tabela e ciklit të larjes

Vini re: (*) Dë të thotë se duhet mbushur shpëlarja në Shpërndarësin në Ndhmë të Shpëlarjes

Programi	Informata për përzgjedhjen e ciklit pastrues	Përshkrimi i ciklit pastrues	Detergjent para/pjata kryesore	Koha e funksionimi (minuta)	Energji (kWh)	Ujë (litra)	Ndihmësi i shpëlarjes
 55° Njëorësh	Për enët pak të ndyra për të cilat nuk ka nevojë efikasiteti të posaçëm të terjes.	Pastrim paraprak (50 °C) Pastrim (55 °C) Shpërlarje (60 °C) Terje	5/25	60	1.15	10	★
 60° Intensiv	Për enët shumë të ndyra dhe tenxheretë e tiganatë dhe tasat e ndryshëm etj. me mbetjet e thara.	Pastrim paraprak (50 °C) Pastrim (60 °C) Shpërlarje Shpërlarje Shpërlarje (70 °C) Terje	5/25 (1 or 2pcs)	170	1.6	18.5	★
eco 45° ECO (*EN50242)	Ky është program standard, i përshtatshëm për pastrimin e enëve të ndyra normal dhe më efikas sa i takon shpenzimit të kombinuar të energjisë dhe ujit për pastrimin e enëve të tilla.	Pastrim paraprak Pastrim (45 °C) Shpërlarje (65 °C) Terje	5/25 (1 or 2pcs)	190	0.90	11	★
 35° Programi i shpejtë	Cikël i shkurtër për enët më pak të ndyra, të cilat nuk kanë nevojë për terje.	Pastrim (35 °C) Shpërlarje (35 °C)		20	0.41	10.6	
 *° Zbutja	Për shpërlarjen e enëve që keni qëllim t'i pastroni më vonë të njejtën ditë.	Pastrim paraprak		15	0.02	4	

Vini re:

*EN50242: Ky program është cikli i testimit. Informacioni për testin e krahasueshmërisë në përputhje me EN50242, si më poshtë:

- Kapaciteti: 12 vendosje
- Pozicioni Lartë për çdo kosh: rrotat e sipërme në shina
- Sistemi në ndihmë të shpëlarjes: 6
- Pl: 0.49vat; Po: 0.45 vat

NDEZJA E PAJISJES

Si të fillojmë një cikël larje:

1. Tërhiqni jashtë koshin e sipërm dhe të poshtëm, vendosni enët dhe shtypni brenda. Fillimisht duhet mbushur koshi i poshtëm dhe më pas ai i sipërm (shikoni seksionin "Si të mbushim lavastoviljen").
2. Shtoni detergjentin (shikoni seksionin me titull "Kripa, detergjenti dhe ndihma e shpërlarjes").
3. Vendosni spinën në prizë. Elektriciteti është 220-240VAC/50HZ, të dhënat e prizës janë 10A 250VAC. Sigurohuni që furnizimi me ujë të jetë graduar në presionin e plotë.
4. Mbyllni derën, shtypni butonin On/Off dhe më pas do të ndizet drita On/Off.
5. Rrotulloni butonin e programit, programi i larjes do të ndryshojë si më poshtë:
Njëorësh -> Intensiv -> ECO -> Programi i shpejtë -> Zbutja

Me të përzgjedhur një program, ndizet drita e reagimit. Më pas shtypni butonin Start/Pause, lavastovilja fillon të punojë.

Ndryshimi i programit...

Kushtet:

1. Një cikël i cili ka nisur tashmë mund të modifikohet vetëm nëse ka nisur prej pak kohësh. Ndryshe detergjenti mund të jetë marrë dhe pajisja mund ta ketë tharë ujin e larjes. Në një rast të tillë, ena e detergjentit duhet të rimbushet (shiko seksionin me titullin "Mbushja me detergjent").
2. Shtypni butonin Start/Pause. Makineria do të vendoset në gjendje gatishmërie. Shtypni butonin e programit më shumë se 3s. Atëherë, mund të ndryshoni programin në ciklin e dëshiruar (shikoni seksionin me titull "Si të fillojmë ciklin e larjes").

Vini re:

Nëse hapni derën gjatë një cikli larje, makineria do të ndalojë. Drita e programit do të ndalojë së pulsuar dhe sinjalizuesi do të lëshojë sinjal çdo minutë derisa të mbyllni derën. Pasi të mbyllni derën, makineria do të rifillojë të punojë pas 10 sekondash.

Nëse makineria e ka të prishur funksionin e kujtesës, pas ndërprerjes së energjisë, ajo do të përfundojë me programin e selektuar.

Keni harruar të vendosni ndonjë enë?

Një enë e harruar mund të shtohet në çdo moment përpara se të hapet ena e detergjentit.

1. Shtypni butonin Start/Pause për të ndaluar larjen.
2. Hapeni pak derën.
3. Pasi të ndalojë së punuari helika e sprucimit, mund ta hapni plotësisht derën.
4. Vendosni enët e harruara.
5. Mbyllni derën.
6. Shtypni butonin Start/Pause; lavastovilja do të fillojë së punuari pas 10 sekondash.

Në fund të ciklit të larjes

Kur cikli i punës të ketë përfunduar, sinjali i lavastoviljes do të sinjalizojë për 8 sekonda dhe më pas do të pushojë. Fikeni pajisjen duke përdorur butonin Power, mbyllni ujin dhe hapni derën e lavastoviljes. Prisni pak minuta përpara se të zbrazni lavastoviljen për të shmangur kontaktin me enët ndërsa ato janë ende të nxehta dhe më lehtësisht të thyeshme. Për më tepër, duke i lënë për pak kohë, ato thahen më mirë.

- Fikni Lavastoviljen

Drita e programit është e ndezur por nuk pulson: vetëm në këtë moment programi ka përfunduar.

1. Fikeni lavastoviljen duke shtypur butonin On/Off.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.

- Hapeni derën me kujdes

Enët e nxehta janë të ndjeshme ndaj goditjeve. Për këtë arsye, enët duhet të ftohen për rreth 15 minuta përpara se të nxirren nga pajisja.

Hapeni derën e lavastoviljes, lëreni hapur dhe prisni disa minuta përpara se të hiqni enët. Në këtë mënyrë, ato do të jenë më të ftohta dhe do të jenë tharë më mirë.

- Zbrazja e lavastoviljes

Është normale që lavastovilja të jetë e lagësht brenda.

Zbrazni koshin e poshtëm fillimisht dhe më pas atë të sipërm, duke shmangur në këtë mënyrë që uji të pikojë nga koshi i sipërm brenda tek enët në koshin e poshtëm.

KUJDES!


Hapja e derës gjatë larjes është e rrezikshme, sepse mund t'ju djegë uji i nxehtë.

7. Mirëmbajtja dhe pastrimi

Sistemi i filtrimit

Filteri ndalon mbetjet e mëdha të ushqimit apo objekte të tjera që të hyjnë në pompë. Mbeturinat mund të bllokojnë filterin; në një rast të tillë ato duhet të hiqen.

Sistemi i filterit përbëhet nga një filter i trashë, një Filter kryesor i sheshtë dhe nga një mikrofilter (një filter i hollë).



Filteri kryesor 1

Ushqimi dhe papastërtitë e mbetura në këtë filter kthehen në pluhur nga një pajisje e veçantë në krahun e poshtëm sprucues dhe më pas uji i çon në kanalin e kullimit.

Filteri i trashë 2

Elementet më të mëdha, si copat e kockave apo xhamat, të cilat mund të bllokojnë kanalin e kullimit mbeten në filterin e trashë. Për t'i hequr elementet e mbetura në filter, rrotulloni me ngadalë rubinetin mbi këtë filter dhe nxirrni jashtë mbeturinat.

Filteri i hollë 3


Ky filter mban mbetje papastërtish dhe ushqimesh në zonën ujëmbledhëse dhe bën të mundur që ato të mos mbesin në enë gjatë ciklit.

Mbetjet në filter

Filteri heq mbetjet e ushqimeve nga uji i larjes me efikasitet, duke bërë të mundur që ai të riciklohet gjatë ciklit. Për këtë arsye, është ide e mirë që të hiqen mbetjet më të mëdha të ushqimeve, të cilat kanë ngecur në filter, pas çdo cikli larës, duke e shpëlarë me ujë çezme filterin gjysmërrethor dhe enën. Për të hequr filterin, tërhiqni dorezën e enës në drejtimin lart.

KUJDES!

- Lavastovilja nuk duhet të përdoret kurrë pa filterat.
- Rivendosja e gabuar e filterit mund të ulë efikasitetin e punës së pajisjes dhe të dëmtojë enët.



Hapi 1: Lëvizni filterin në drejtimin e kundërt të akrepave të orës.

Hapi 2: Ngrijeni filterin lart.

Vini re: Kur ndiqni këtë procedurë nga hapi 1 në hapin 2, sistemi i filterit çaktivizohet; kur e ndiqni nga Hapi 2 në Hapin 1, sistemi i filterit instalohet.

Vërejtje:

- Kontrolloni filterat nëse janë bllokuar pas çdo përdorimi të lavastoviljes.
- Me anë të filterit të trashë, mund të hiqni sistemin e filterit. Hiqni çdo mbetje ushqimore dhe pastroni filterat me ujë çezme.

Vini re: Mbetjet në filtera duhet të pastrohen një herë në javë.

Si të pastrojmë filterin

Për të pastruar filterin e trashë dhe atë të hollë, përdorni një furçë. Ribashkoni pjesët e filterit siç tregohet në figurat në faqen e fundit dhe rivendoseni të gjithë strukturën në lavastovilje, duke e pozicionuar atë në vendin e vet dhe më pas ngjisheni poshtë.

KUJDES! Gjatë pastrimit të filtrave mos i godisni ata, spese mund të dëmtohen dhe për pasojë do të ulej efikasiteti i lavastoviljes.

Kujdesi për lavastoviljen

Paneli i kontrollit mund të pastrohet me një leckë fare pak të lagur.

Pas pastrimit, thajeni mirë.

Për pjesën e jashtme, përdorni një dyll të mirë lyeje për paastisjet.

Mos përdorni kurrë objekte të mprehta, shtupa gërryerse apo pastrues të ashpër në asnjë pjesë të lavastoviljes.

Si të pastrojmë derën



Për të pastruar anët rreth derës, duhet të përdorni vetëm një copë leckë të lagur, të butë dhe të ngrohtë. Mos përdorni pastrues me sprucim të asnjë lloji, për të shmangur futjen e ujit në pjesën ku mbyllet dera dhe tek elementët elektrikë.

KUJDES!

- Mos përdorni kurrë një pastrues sprucues për të pastruar panelin e derës pasi mund të dëmtohet pjesa ku mbyllet dera si edhe elementet elektrikë.
- Elementët gërryes ose peshqirët prej letre nuk duhet të përdoren, për shkak të rrezikut për të krijuar gërryerje ose për të lënë shenja mbi sipërfaqet e çelikut të cilat nuk kanë njolla.

Mbrojtje kundër ngrirjes

Ju lutemi të merrni masa mbrojtëse për lavastoviljen gjatë dimrit. Pas çdo cikli larës, ju lutemi të vijoni si më poshtë:

1. Shkëpusni elektricitetin nga lavastovilja.
2. Ndërprisni furnizimin me ujë dhe shkëputeni tubin e ujit nga valvula e ujit.
3. Thajeni ujin nga tubi furnizues dhe nga valvula e ujit (Përdorni enë për të mbledhur ujin).
4. Rilidheni tubin e furnizimit me ujë me valvulën e ujit.
5. Hiqeni filterin në fund të tubit dhe përdorni një sfungjer për të thithur ujin në ujëmbledhës.

Vini re: Nëse lavastovilja juaj nuk mund të punojë për shkak të akullit, ju lutemi të kontaktoni profesionistët e shërbimit.

Si të pastrojmë krahët sprucues

Krahët sprucues duhen pastruar rregullisht, sepse kimikatet e forta të ujit do të bllokojnë sprucimet dhe kushinetat e krahut sprucues.

Për të hequr krahun e sipërm sprucues, mbani bulonin; për të hequr krahun rrotullojeni këtë të fundit në drejtim të akrepave të orës.

Për ta hequr krahun e poshtëm sprucues, ngrini lart krahun sprucues.

Lajini krahët me ujë të ngrohtë me sapun, dhe përdorni një furçë të butë për të pastruar sprucuesit.

Rivendosini përsëri pasi t'i keni shpëlarë mirë.



SI TA MIRËMBANI LAVASTOVLJEN

- Pas çdo larje Pas çdo larje, shkëpusni furnizuesin e ujit nga pajisja dhe lini dyert paksa hapur, në mënyrë që të mos mbetet lagështirë apo aromë brenda në të. - Hiqni prizën Përpara se të pastroni ose të filloni të kujdeseni për pajisjen, gjithmonë hiqni spinën nga priza. - Mos pastroni me tretësia apo element gërryes Për të pastruar pjesën e jashtme dhe pjesët e gomës së lavastoviljes, mos përdorni tretësia apo pastrues gërryes. Për të hequr njollat nga sipërfaqet e brendshme, përdorni një leckë të lagur me ujë dhe pak uthull, apo një produkt pastrues që përdoret enkas për lavastoviljet.	- Kur pajisja nuk është përdorur për një kohë të gjatë Rekomandohet që ta lani lavastoviljen me një cikël larje dhe më pas të hiqni spinën nga priza, fikni furnizuesin me ujë dhe dera lihet pak hapur. Kjo do të ndihmojë që izolantët e derës të jetojnë më gjatë dhe do të pengojë që erërat e këqija të mund të krijohen brenda pajisjes. - Lëvizja e pajisjes Nëse pajisja duhet të lëvizet, përpikuni ta mbani në pozicion vertikal. Nëse është e nevojshme, përpikuni ta poziciononi mbi kurriz. - Izolantët Një nga faktorët që krijojnë aromë brenda lavastoviljes, janë ushqimet që ngecin tek izolantët. Një pastrim periodik me një sfungjer të lagur do ta parandalojë një efekt të tillë.
---	---

UDHËZIME PËR INSTALIMIN

Si të pozicionojmë pajisjen

Vendoseni pajisjen në pozicionin e dëshiruar. Pjesa e pasme duhet të jetë e mbështetur në mur, dhe anët duhet të jenë përgjatë mureve ose rrafteve aty pranë. Lavastovilja pajiset me furnizuesin e ujit dhe me zorrat thithëse, të cilat mund të pozicionohen ose në të djathtë ose në të majtë, për të lehtësuar instalimin efikas.

NIVELIMI I PAJISJES



Sapo të pozicionohet apo të nivelohet pajisja, lartësia e lavastoviljes mund të përshatet me anë të nivelit filetues të këmbëve.

Megjithatë, në çdo rast pajisja nuk duhet të ketë pjerrtësi më të madhe se 2°.

PËR SA KA TË BËJË ME LIDHJEN E ENERGJISË KUJDES!

Për siguri personale:

- Mos përdorni tela zgjatues ose adaptues me këtë pajisje.
- Kurrë mos prisni apo hiqni tokëzimin.
- Lidhja me anë të telit të elektricitetit.

Kërkesat elektrike


Ju lutemi, referohuni etiketës klasifikuese, për të mësuar voltazhin. Lidhjeni lavastoviljen me pajisjen e duhur që furnizon me energji. Përdorni siguresën e duhur 10 amp; siguresa e shtyrjes kohore apo dëmtuesi i qarkut duhet të përdoren vetëm për këtë pajisje.

Lidhja elektrike

Sigurohuni që voltazhi dhe frekuenca e energjisë të korespondojnë me ato në tabelën klasifikuese. Vendosni spinën në një prizë e cila është tokëzuar siç duhet. Nëse priza elektrike, me të cilën lidhjet spina e pajisjes, nuk lidhet siç duhet me prizën, mund të shkaktohet mbinxhe dhe djegie.

LIDHJA ME UJIN

Lidhja me ujin e ftohtë.



Aparatin nevojitet të kyçni në ujësjellës me kompletin e rinj të gypave. Mos përdorni komplete gypash të vjetër.

Shtypja e ujit nevojitet të jetë ndërmjet të 0,04 MPa dhe 1 MPa. Nëqoftëse është shtypja nën vlerën minimale, këshillohuni me kompaninë e ujësjellësit.

Krejtësisht tërheqni gypin mbrojtës furnizues nga sirtari për ruajtje, i cili gjendet në anën shpinore të makinës për pastrimin e enëve.

Përforconi vidhat në gypin mbrojtës furnizues në rubinetën me 3/4 – col vidhë. Para se të nisni makinën për pastrimin e enëve, krejtësisht hapni rubinetën e ujit.

PËR GYPIN MBROJTËS FURNIZUES TË UJIT

Gypi mbrojtës furnizues për ujin përmban muri të dyfishtë. Sistemi i gypave parandalon lëshimin edhe në rastet kur plas gypi, sepse në këtë rast uji rrjedh në hapësirën ndërmjet të gypit furnizues dhe mbështjellësin e jashtëm të rrudhur.

PARALAJMËRIM!

Gypi, të cilin e lidhni me rubinetën mbi lavaman në kuzhinë mund të plas, nëqoftëse është e kyçur në linjën e njejtë të ujësjellësit sikur makina për pastrimin e enëve. Nëqoftëse në lavamanin tuaj keni llojin e tillë të gypit, rekomandojmë që ta shkyçni dhe shtuponi hapësirën.

Shkyçja e gypit mbrojtës për furnizim me ujë

1. Mbyllni furnizimin me ujë.
2. Lironi shtypjen e ujit me trusjen e pullës për lirin e shtypjes. Kështu do të lironi shtypjen dhe do të mbron veten dhe pajimet në hapësirën para spërkatjes së fuqishme
3. Zhvidhoni mbaresën e gypit mbrojtës nga rubineta.


KYÇJA PËR UJIN E FTOHTË

Kyçni gypin furnizues për ujin e ftohtë në rubinetë (3/4 col) dhe binduni që gypi është i përforcuar mirë. Nëqoftëse gypi furnizues për ujë është i rinj ose nëqoftëse gjatë kohë nuk e keni përdorur, lëshoni nëpër të ujin e rrjedhshëm, që të bindeni që uji rrjedh i pastër dhe pa ndyrësira. Nëqoftëse nuk veproni kështu, gypi furnizues për ujë mund të shtupohet, e kjo mund të dëmtojë aparatin.

PARALAJMËRIM! Ju lutemi që pas përdorimit të makinës për pastrimin e enëve të mbyllni rubinetën, resp. ventilin e ujit.

LIDHJA E ZORRËS SË KULLIMIT

Vendoseni zorrën e kullimit në një tub kullimi me një diametër prej 40mm, ose lëreni në lavaman duke u siguruar që të mos përthyeret. Pjesa e sipërme e zorrës duhet të jetë më pak se 1000mm.



SI TË KULLOJMË UJIN NGA ZORRA

Nëse lavamani është 1000 më i lartë nga dyshemeja, uji nuk mund të kullohet direkt në lavaman. Do të jetë e nevojshme që uji të kullohet nga zorra në një enë e cila është jashtë, në një pozicion më të ulët se lavamani.

DERDHJA E UJIT

Lidhni zorrën e kullimit të ujit. Zorra e kullimit duhet të jetë e fiksuar mirë në mënyrë të tillë që të mos ketë rrjedhje të ujit. Sigurohuni se zorra kulluese nuk është përdredhur apo shtypur.

ZGJATIMI I ZORRËS

Nëse keni nevojë për të zgjatur zorrën e kullimit, përdorni një zorrë të ngjashme.

Ajo nuk duhet të jetë më e gjatë se 4 metra, sepse në të kundërt do të ulej efekti pastrues i lavastoviljes.

LIDHJA E SIFONIT

Lidhja e mbetjeve duhet të jetë në një lartësi jo më pak se 1000mm (maksimumi) nga fundi i enës. Më pas duhet të vendoset zorra e kullimit të ujit.

Vënia në punë e lavastoviljes

Hapat e mëposhtëm duhen kontrolluar përpara se lavastovilja të vihet në punë:

1. Lavastovilja është sistemuar dhe niveluar siç duhet.
2. Valvula e furnizimit është e hapur.
3. Lidhjet e zorrave të mbushjes janë të tendosura plotësisht dhe nuk pikojnë.
4. Telat janë të lidhur fort.
5. Është ndezur lidhja elektrike.
6. Janë lidhur zorrat furnizuese dhe shkarkuese.
7. Të gjitha materialet paketimes dhe printimet duhet të nxirren nga lavastovilja.

Vëmendje: Pas instalimit, sigurohuni ta ruani këtë manual.

Përmbajtja e këtij manuali është shumë e dobishme për përdoruesit.

Këshilla për problemet
Përpara se të telefononi shërbimin

Shikoni tabelat në faqet në vijim, sepse ato mund të shmangin nevojën që të telefononi shërbimin.

	Problemi	Shkaqet e mundshme	Çfarë duhet bërë
	Lavastovilja nuk nis të punojë	Është djegur spina ose është aktivizuar prishësi i qarku	Zëvendësoni spinën ose riprogramoni prishësin e qarkut. Hiqni çdo pajisje tjetër që ndan të njëjtin qark me lavastoviljen.
		Nuk është ndezur furnizuesi me energji	Sigurohuni që lavastovilja është ndezur dhe që dera të jetë mbyllur plotësisht. Sigurohuni që spina është vendosur siç duhet në prizën në mur.
		Presioni i ujit është i ulët	Kontrolloni nëse furnizuesi me ujë është lidhur siç duhet dhe se uji është hapur.
		Dera e lavastoviljes nuk është mbyllur siç duhet.	Sigurohuni se dera është mbyllur siç duhet.
Probleme teknike			
	Uji nuk pompohet nga lavastovilja	Lidhni zorrën e kullimit	Kontrolloni zorrën e kullimit
		Filteri është bllokuar	Kontrolloni filterin e trashë (shikoni seksionin "Si të pastrojmë filtrin")
		Lavamani i kuzhinës është i bllokuar	Kontrolloni nëse lavamani i kuzhinës kullon mirë. Nëse problemi është lavamani dhe jo kullimi, mund t'ju nevojitet një hidraulik më shumë sesa një teknik për lavastoviljen.
	Shkumë detergjenti në tub	Detergjent i papërshtatshëm	Për të shmangur shkumën, përdorni vetëm detergjentin special për lavastoviljen. Në një rast të tillë, hapeni lavastoviljen dhe lëreni shkumën të shkrijë. Hidhni një litër ujë të ftohtë në tub. Mbylleni mirë lavastoviljen dhe përzgjidhni cilindro cikël. Lavastovilja do ta kullojë ujin që në hapin e parë. Hapeni derën pasi ka ndodhur kullimi dhe kontrolloni nëse shkuma është larguar. Përsëriteni nëse është e nevojshme.
		Uji shpëlarës i derdhur	Fshini menjëherë ujin shpëlarës që mund të jetë derdhur.
	Tubi i brendshëm i njoollor	Është përdorur detergjent me ngjyres	Sigurohuni që detergjenti të mos ketë ngjyres.
Probleme të përgjithshme	Shtresë e bardhë në sipërfaqen e brendshme	Minerale të ujrave të fortë	Për të pastruar pjesën e brendshme, përdorni një sfungjer të lagur me detergjent lavastovilje dhe vendosni doreza plastike. Mos përdorni asnjë detergjent tjetër përveç atij të lavastoviljes, për të shmangur rrezikun e shkumës.
	Ka njolla ndryshku tek lugët, pirunjtë dhe thikat	Artikujt e dëmtuar nuk janë rezistent ndaj gërryerjes	
		Një program nuk funksionon pasi është hedhur kripa e lavastoviljes. Gjurmët e kripës kanë ndërhyrë në ciklin e larjes	Gjithmonë përdorni programin e larjes së shpejtë pa enë në lavastovilje dhe pa përzgjedhur funksionin Turbo (nëse ai është i pranishëm), pasi të keni shtuar kripën e lavastoviljes.
		Kapaku nuk mbyllet plotësisht	Kontrolloni kapakun. Sigurohuni që të mbyllet plotësisht.
Zhurmë	Zhurmë goditëse në enën e larjes	Njëri nga krahët e sprucimit godet ndonjë nga enët në	Ndërpreni programin dhe riorganizoni enët, të cilat pengojnë krahun e

 Rezultate të pakënaqshme		kosh	sprucimit.
	Zhurme përplasëse në enën e larjes	Enët mund të jenë shpërhapur në pajisje.	Ndërpisni programin dhe rivendosni enët.
	Zhurme goditëse në tubat e ujit	Kjo mund të shkaktohet për shkak të instalimit gjatë montimit apo nga instalimi i tubave.	Një problem i tillë nuk ka ndikim në funksionimin e lavastoviljes. Nëse jeni në dyshim, kontaktoni një hidraulik profesionist.
	Enët nuk janë të pastra	Enët nuk janë vendosur siç duhet	Shikoni shënimet tek "Mbushja e koshave të lavastoviljes"
		Programi nuk është mjaftueshëm i fuqishëm	Përzgjidhni një program më intensiv. Shikoni "Tabelën e ciklit të larjes"
		Nuk qarkullon mjaftueshëm detergjent	Përdorni më shumë detergjent ose ndryshojeni atë
		Enët bllokohen rrugën e krahëve sprucues	Rivendosni enët në mënyrë të tillë që sprucimi të rrotullohet lirshëm.
		Kombinimi i filterit në dhomën e larjes nuk është i pastër dhe nuk është përshtatur siç duhet. Kjo mund të bllokohet sprucimin.	Pastroni dhe/ose rregulloni kombinimin e filterit. Pastroni krahët e sprucimit. Shikoni "Si të pastrojmë krahët e sprucimit".
	Mjegullimi i enëve prej qelqi	Kombinimi i ujit të butë dhe shumë detergjent	Përdorni më pak detergjent nëse uji është i butë dhe përzgjidhni një cikël më të shkurtër për të larë enët prej qelqi dhe për t'i pastruar ato.
	Njolla të zeza ose gri në enë	Pajisjet alumini mund të jenë fërkuar me enët e tjera	Përdorni pastrues pa gërryes për të eliminuar njollat.
Rezultatet e tharjes janë të pakënaqshme	Detergjent i mbetur në dhomat e shpërndarjes	Enët kanë bllokuar dhomat e detergjentit	Rivendosni enët në mënyrën e duhur.
	Enët nuk thahen	Nuk janë vendosur në mënyrën e duhur	Mbusheni lavastoviljen sipas udhëzimeve të sygjera
		Shumë pak ndihmë në shpëlarje	Rrisni sasinë e shpërndarësit ndihmues në shpëlarje/rimbushni shpërndarësin ndihmues në shpëlarje
		Enët nxirren shumë shpejtë	Mos e zbrasni menjëherë pas larjes lavastoviljen tuaj. Hapeni pak derën kështu që të mund të dalë avulli. Filloni ta boshatisni lavastoviljen kur enët të jenë të ngrohta. Boshatisni koshin e poshtëm fillimisht. Kjo pengon që uji të pikojë nga enët në koshat e sipërm.
		Përzgjidhet programi i gabuar	Në një program të shkurtër temperatura e larjes është e ulët. Kjo ul edhe cilësinë e pastrimit. Përzgjidhni një program me një kohë të gjatë larje.
		Përdorimi i thikave, lugëve dhe pirunjeve me veshje të një cilësie të ulët	Kullimi i ujit është më i vështirë me këta artikuj. Artikujt e kësaj kategorie nuk janë të përshtatshëm për t'u larë në lavastovilje.


Kodet e gabimit

Në rast të disa gabimeve, makina për pastrimin e enëve do të shfaq shenjën e gabimit.		
Shenja	Domethënia	Shkaqet e mundshme
E1 (Llambëza sinjalizuese për zbutje pulson.)	Koha e përzgjat e furnizimit me ujë.	Rubinetat nuk është krejtësisht të çelur; furnizimi me ujë është i penguar; shtypja e ujit është tejte e ulët.
E3 (Llambëzat sinjalizuese për zbutje dhe programin e shpejtë pulsojnë.)	Uji nuk arrin temperaturën adekuate.	Gabimi në elementin për nxehje.
E4 (Llambëza sinjalizuese për programin Eco pulson.)	Vërshimi i ujit.	Njëri nga elementet e makinës për pastrim lëshon ujin.

KUJDES!

- Nëse ka një mbimbushje me ujë, mbyllni furnizuesin kryesor përpara se të thërrisni shërbimin.
- Ka ujë në enën e poshtme për shkak të mbimbushjes apo rrjedhjes së vogël. Uji duhet të hiqet përpara se të ristartojmë lavastoviljen.


Informacion teknik



Lartësia :	845mm
Gjerësia :	598mm
Thellësia :	600mm(me derën e mbyllur)
Presioni i ujit:	0.04-1.0MPa
Furnizimi me energji:	Shikoni tabelën ranrenditje
Kapaciteti:	12 vende

Rradhitja e enëve në përputhje me EN50242:

1. Shporta e epërme:



Filxhanat



Pjatat e vogla



Gotat



Tasi i vogël për servim



Tasi mesatar për servim



Tasi i madh për servim



Pjata për ëmbëlsira



Pjatat (të cekëta) për gjellën kryesore




Pjatat për supë



Tabakoja ovale

2 Shporta e poshtme:



3. Shporta me pajisje:

1	2	1		5	5	5	5	5	5		1	2	1
2	2	2			3			3		3	3		2
1	2	1		5	5	5	5	5	5		1	3	1
1	2	1		4	4	4	4	4	4		3	3	3
2	2	2			8			7		3	3	3	3
1	2	1		4	4	4	4	4	4	6		6	

1 lugë për supë



5 lugë për desert



2 piruni



6 lugë për servim



3 thika




7 piruna për servim



4 lugë çaji



8 lugë për salcë



Informatat për testin krahasues janë të shënuara në përputhje me standardin N 50242.

Kapaciteta: 12 komplete

Pozicioni i shportës së epërme: pozicioni i poshtëm

Programi: Eko (i pranueshëm për ambientin)

Sasia e lëndës së shtuar për shpërlarje: 6

Rregullimi i mbaresës për zbutje: H3

Të dhënat teknike

Bilanci i lavastoviljes sipas Direktivës së BE 1059/2010

Prodhuesi	GORENJE
Tipi/Përshkrimi i standardit	GS62010W,GS62010S,GS62110W
Vende	12
Klasa e efikasitetit e përvitshme 1	A++
Konsumi i energjisë 2	258kWh
Konsumi i energjisë i ciklit standard të pastrimit	0.90 kWh
Konsumi i energjisë në gjendje të fikur	0.45
Konsumi i energjisë në gjendjen e krahut të madh aktiv	0.49
Konsumi i përvitshëm i energjisë 3	2520 litër
Klasifikimi i efikasitetit të tharjes 4	A
Cikli standard i pastrimit 5	ECO 45°C
Kohëzgjatja e programit të ciklit standard të pastrimit	190 min
Niveli i zhurmës	49 dB(A) re 1 pW
Montimi	I pavarur

Vini re:

1 A+++ (efikasiteti më i lartë) deri në D (efikasiteti më i ulët)

2 Konsumi i energjisë “258” kWh në vit, bazuar në 280 cikle standarde të pastrimit duke përdorur ujë të ftohtë dhe konsumi i tipit me energji të ulët. Konsumi aktual i energjisë varet nga mënyra se si përdoret pajisja.

3 Konsumi i ujit “3080” litër në vit, bazuar në 280 cikle standarde të pastrimit. Konsumi aktual i ujit varet nga mënyra se si përdoret pajisja.

4 A (efikasiteti më i lartë) deri në G (efikasiteti më i ulët)

5 Ky program është i përshtatshëm për pastrimin e serviseve të tavolinave mesatarisht të papastra, i cili është edhe programi më efikas për sa ka të bëjë me kombinimin e energjisë dhe konsumit të ujit për atë kategori enësh.

Pajisja përmbush standardet europiane dhe udhëzimet në versionin aktual:

- LVD2006/95/EC
- EMC2004/108/EC
- ErP2009/125/EC

Vlerat e mësipërme janë marrë në përputhje me standardet në kushte specifike gjatë punës.

Rezultatet mund të ndryshojnë sipas sasisë dhe nivelit të papastërtisë së enëve, fortësisë së ujit, sasisë së detergjentit, etj.

Manuali bazohet në standardet dhe rregullat e Bashkimit European.